



U R D H Ë R

Nr. 98, datë 16.07.2018

PËR PËRCAKTIMIN E GRUPIT TË KOORDINATORËVE PËR ZBATIMIN PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR DIASPORËN 2018-2024

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të Vendimit nr. 259, datë 09.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe planit të Veprimit”,

U R D H Ë R O J:

1. Përcaktimin e Grupit të Koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 të miratuar me VKM nr. 259, dt. 09. 05. 2018, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe planit të Veprimit”.
2. Grupi i Koordinatorëve të kryesohet nga Ministri i Shtetit për Diasporën.
3. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit të përfaqësohen në nivel zëvendësministri, si edhe nga 2 (dy) përfaqësues të tjerë, specialistë të fushës dhe të jenë, si më poshtë vijon:
 - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
 - Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
 - Ministria e Kulturës;
 - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
 - Ministria e Brendshëm;
 - Ministria e Drejtësisë;
 - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
 - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
4. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, të përfaqësohet nga Drejtori i Kabinetit. Akademia e Shkencave, INSTAT-i si edhe Agjencia Kombëtare për Diasporën do të përfaqësohen nga titullarët e vet.



5. Koordinatorët janë përgjegjës për bashkërendimin e punës për zbatimin e masave të Planit të Veprimit në institucionin të cilin përfaqësojnë.
6. Grupi i Koordinatorëve ka për detyrë:
 - a) ndjekjen dhe zbatimin e masave të përcaktuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024.
 - b) përcaktimin e detajimit e kostove dhe të indikatorëve për të gjitha masat e parashikuara në planin e veprimit.
7. Koordinatorët të mblidhen jo më pak se një herë në muaj dhe sa herë është e nevojshme, me njoftim të kryetarit.
8. Në mbledhjet e grupit të koordinatorëve mund të ftohen të marrin pjesë edhe ekspertë të strukturave të tjera, si organizata jofitimprurëse, organizmat ndërkombëtarë, universitetet dhe personalitete të fushës.
9. Ngarkohen titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 3, të këtij urdhri, që brenda 5 (pesë) ditësh nga hyrja në fuqi e tij, të caktojnë përfaqësuesit e tyre.
10. Ngarkohet Ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, INSTAT-i, Akademia e Shkencave, Agjencia Kombëtare për Diasporën, për ndjekjen e zbatimit e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA